



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-31324/25
Kaçanik, 30.12.2025

Në mbështetje të nenit 12. 2 (d) të Ligjit Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008), të nenit 61 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-31324/25 prej datës 23.12.2025, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 dhjetor 2025, merr këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ÇDO LINDJE TË LEHONAVE

1. Me këtë Vendim bëhet ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej 200€ për çdo lindje të lehonave, të cilat janë qytetare rezidente të komunës së Kaçanikut.
2. Mjetet financiare për këtë qëllim, do të merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do kujdesen : Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni